



Formulimi i Vizionit (4)

*“Në fund të fundit është e rëndësishme ta mbajmë në mend se nuk mund të bëhemi ata që do të duhej të ishim, duke bërë ashtu që të mbetemi ata që jemi”
Max Depree*

Ata që nuk kanë vizion zakonisht mbeten ata që janë. Edhe kurrikulat që nuk kanë vizion bëjnë që nxënësit të jenë ata që janë, në rastin më të mirë, sepse kurrikulat pa vizion mund të bëjnë edhe me keq, me që nxënësit jo vetëm që do të mbeten ata që janë, por të degradojnë, të dëmtohen – keq-edukohen dhe keq-formohen.

Por, përcaktimi i vizionit është i domosdoshëm, por nuk është i mjaftueshme, sepse ai është, siç kemi thënë një ëndërr një imazh i dëshiruar. Ai, si i tillë është i përgjithësuar, është i largët, është një dritë në fund të tunelit të errët që na shërben si piketë orientimi. Ai është një deklaratë mobilizuese, sfiduese që hap shpresa. Ai na tregon drejtimin e duhur drejt të cilit duhet ecur, Arritja e vizionit kërkon përfarimin dhe ndriçimin më të mirë të tij. Kjo zakonisht bëhet me përcaktimin e qëllimeve kurrikulare.

Qëllimi paraqet një aspiratë më pak të përgjithshme dhe më afat-shkurtë. Qëllimet janë rezultatet e dëshiruara që duhet t'i arrijnë nxënësit, si pasoje e zhvillimit të kurrikulit. Për dallim nga vizioni, qëllimet nuk janë deklarata të hapura. Ato janë deklarime konkrete. Një vizion mund të ketë më shumë qëllime. Qëllimet mund të lidhen me kornizën kurrikulare, me plane programe- kurrikula lëndor, por edhe me kurrikula shkollor. Në kornizën e kurrikulit qëllimet mund të definojnë si:

- Forcimi i demokracisë
- Rritje e mirëqenies
- Punësim i njerëzve
- Mbrojtje e mjedisit
- Ruajtje e paqes
- Rimëkëmbje morale
- Përgatitja e qytetarëve për të marrë pjesë në tregun botëror të punës
- Përgatitja për të nxënë gjatë gjithë jetës
- Formimi i shkathtësive të shekullit XXI
- Zhvillimi i kompetencave

Një formë e përcaktimit të qëllimeve të arsimit që mund të jetë pjesë e kornizës kurrikulare është dhënë nga Presidenti Bush (i vjetër) dhe guvernatorët e SHBA-ve. Ata përcaktuan një listë prej gjashtë qëllimesh për shkollat e kombit të cilat i prezantojmë në vazhdim

1. Deri në vitin 2000, të gjithë fëmijët në Amerikë, do të nisin shkollat të gatshëm për të mësuar
2. Deri në vitin 2000, përqindja e mbarimit të shkollës së mesme do të rritet në të paktën deri në 90%
3. Deri në vitin 2000, nxënësit amerikan që nga klasa e katërt, e tetë dhe e dymbëdhjetë do të jenë në gjendje për të treguar aftësi në lëndët kryesore (anglisht, matematikë, shkencë, histori dhe gjeografi)
4. Deri në vitin 2000, nxënësit e SHBA-ve do të jenë të parët në Botë në arritjet në shkencë dhe në matematikë
5. Deri në vitin 2000, secili amerikan i rritur do të jetë i shkolluar dhe do të zotërojë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të konkurruar në një ekonomi globale dhe për të ushtruar të drejtat dhe përgjegjësitë qytetare
6. Deri në vitin 2000, secila shkollë në Amerikë do të jetë e lirë nga droga dhe dhuna dhe do të jetë një mjedis i disiplinuar që ndihmon të mësuarit)

Shkroi: Halim Hyseni

Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

Programi i granteve për zhvillimin e shkollave

- Gjatë muajve korrik dhe gusht janë zhvilluar shumë aktivitete në kuadër të projektit të granteve shkollore. Fokusi kryesor gjatë kësaj kohe ka qenë ndihma shkollave përfituese të rundit të parë për të përfunduar realizimin e projekteve dhe procedimin e mbetjeve nga realizimi i tyre. Gjatë kësaj kohe, bashkëpunëtorët profesional të terrenit kanë bërë monitorimin e punës së bërë nga shkollat dhe kanë intervenuar me këshilla dhe ndihmë aty ku është paraqitur nevoja.
- Përveç ndihmës që u kanë dhënë shkollave të rundit të parë, BPT kanë qenë të angazhuar të punojnë edhe me shkollat e rundit të dytë për të përfunduar planet zhvillimore të tyre dhe projekt propozimet. Ndihma shkollave të rundit të dytë do të vazhdojë edhe gjatë muajit shtator.

KOSOVISION Contest

- Pas mbajtjes së ceremonisë kryesore të projektit (11 qershor). Janë zhvilluar aktivitete përmbyllëse të projektit që kryesisht kishin të bëjë me përgatitjet e raporteve. Përfundimi i vitit të tretë të KOSOVISION CONTEST u konsideruar shumë i suksesshëm. Tregues kryesor i këtij suksesi janë me qindra projekte të zhvilluara gjatë këtyre tre vjetëve të fundit. Duke e vërejtur këtë sukses të projektit, donatorët janë treguar të gatshëm që ta përkrahin projektin edhe për tri vitet e ardhshme. Gjatë muajve korrik dhe gusht kanë filluar përgatitjet për vazhdimin e këtij projekti edhe për tri vitet e ardhshme.

Projekti do të vazhdojë të implementohet së bashku me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Gjatë muajit korrik janë mbajtur disa punëtori për zhvillimin e programit ndërsa gjatë muajit gusht është punuar në hartimin dhe botimin e materialeve për mësimdhënësit të cilët gjatë këtij viti do të jenë pjesë e projektit.

Të gjitha aktivitetet e këtij projekti do të fillojnë në muajin shtator kur edhe nënshkruhet marrëveshja me Zyrën Zvicerane dhe Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit

- Projekti “Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e edukimit”, financuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë, ka përfunduar në muajin korrik, me një ceremoni përmbyllëse, ku edhe u prezantua raporti i dytë i monitorimit të gjendjes së të drejtave të fëmijës në shkollat pjesëmarrëse të projektit.



- Gjithashtu në kuadër të projektit është organizuar edhe një punëtori gjysmë ditore për rishikimin e kornizës së monitorimit. Kornizë do të dorëzohet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për nevojat e tyre.

- Në muajin gusht është punuar kryesisht në raportin final të projektit.

Parandalimi i dhunës në shkolla

- Gjatë këtyre muajve ekipi i projektit kryesisht ka punuar në finalizimin e raporteve të monitorimit. Raportet janë hartuar për secilën shkollë të vizituar. Ato përmbajnë fakte (fotografi) të cilat paraqesin gjendjen e shkollës në momentin e monitorimit. Më pastaj, raportet përmbajnë rekomandime apo hapa që duhet ndërmarrë nga udhëheqësit e shkollës dhe ata të DKA-së përkatëse për të përmirësuar / avancuar shkollën.
- Gjithashtu gjatë kësaj kohe shumica e Komiteteve Komunale dhe Rajonale kanë dërguar raportet për punën e tyre. Pas përfundimit të raportimit nga ana e Komiteteve, do të organizohet një takim i përbashkët për të planifikuar aktivitetet e ardhshme.
- Nga numri i ardhshëm i Letrës Informative (muaji shtator) do ta publikojmë një material gjithëpërfshirës për gjendjen në shkollat e vizituara në kuadër të këtij projekti.

Qasja Tërësektoriale në Arsim – EU EDUCATION SWAp

- Projekti Qasja Tërësektoriale në Arsim - EU EDUCATION SWAp ka filluar të implementohet në muajin tetor të vitit 2009. Ky projekt financohet nga Komisioni Evropian dhe menaxhohet nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë.

Projekti implementohet nga konsorciumi i përbërë nga Cambridge Education, Qendra për Arsim e Kosovës, Education 2000+ Consulting dhe Tribal Helm.

- Një nga ngjarjet më të rëndësishme ishte miratimi nga qeveria i Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2011-2016. Projekti ka ndihmuar në finalizimin e tij si dhe në prodhimin e planit të parë vjetor të PSAK-ut për vitin 2011. Kjo i ka mundësuar Projektit të vazhdojë tutje të mbështes MASHT-in në formimin e një Task Force të brendshme për mbikëqyrje të implementimit të Planit, si dhe në formimin e një Komiteti Drejtues të PSAK-ut të përbërë nga përfaqësues të MASHT-it dhe ministrive tjera e donatorëve relevant.

- Projekti ka prodhuar një Doracak të ‘Mjeteve për Planifikim në Arsim’, në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze, së bashku me një CD e cila përmban format dhe përshkrimet e nevojshme që u mundësojnë përdoruesve të hartojnë planet e tyre vetanake. Këto mjete do të përdoren nga projekti në punëtoritë e ardhshme për MASHT-in dhe DKA-të. Gjithashtu projekti gati ka finalizuar dizajnimin dhe zhvillimin e një Instrumenti për Planifikim Financiar, i cili do t'i mundësojë MASHT-it të planifikojë duke u bazuar në skenare të ndryshme, për shembull, të modelojë ndikimin e kërkesave financiare të raporteve të ndryshme për nxënës/mësimdhënës, ose futjen e klasës parafillore në arsimin e obligueshëm. Derisa të dyja këto produkte janë të rëndësishme veçanërisht për sektorin e arsimit, me pak modifikime mund të përdoren edhe nga sektorë tjerë.

Edukimi për Drejtësi shoqërore (EDSH)

- Në kuadër të projektit “Edukimi për Drejtësi shoqërore”, financuar nga OSBE, në fund të muajit qershor dhe fillim të

muajit korrik është zhvilluar një trajnim katërditor. Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin mësimdhënës nga komunitete të ndryshme që jetojnë në Kosovë. Qëllimi i trajnimit ishte që mësimdhënësit të pajisen me njohuri dhe informacione për të krijuar një klasë ku të gjithë nxënësit trajtohen të barabartë pa marrë parasysh përkatësinë e tyre (etnike, fetare, ekonomike). Trajnim ka shkuar mjaft mirë dhe pjesëmarrësit janë ndarë të kënaqur dhe janë shprehur të gatshëm që njohuritë e fituara të i zbatojnë në klasë. Programi i trajnimit është i akredituar dhe mësimdhënësit do të pajisen me certifikata.

Mbështetje e BE-së për Zbatimin e Strategjisë për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas (EU-SIMRAES)

■ Në kuadër të projektit “Mbështetje e BE-së për Zbatimin e Strategjisë për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas”, financuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë, gjatë këtyre muajve janë zhvilluar këto aktivitete:

■ QM i kanë pasur vetëm dy programe aktive, atë të aktiviteteve rinore dhe programit të shkrim leximit. Gjatë këtyre dy muajve QM-të kanë raportuar se fëmijët kanë vazhduar të frekuentojnë qendrat si dhe janë organizuar disa aktivitete sportive dhe argëtuese. Sa i përket programit të shkrim leximit po ashtu ka vazhduar edhe në këtë periudhë por pjesëmarrja shkaku i pushimeve verore nuk ka qenë aq aktive si në muajt e kaluar.

■ Gjatë muajit gusht 2011, KEC e ka shpallur tenderin për pako shkollore ku synohet të shpërndahen rreth 1000 pako për nxënësit që vijojnë shkollimin në ciklin e ulët dhe ciklin e artë. Pakot

ndihmëse shkollore janë te ndara në bazë të cikleve dhe nevojave për te dy kategoritë (klasa 1-5 dhe klasa 6-9).

■ KEC ka evidentuar se 35 nxënës të shkollave të mesme të cilët janë përfitues të bursës, e kanë përfunduar shkollën dhe 4 studentë i kanë përfunduar studimet. Në këtë rast për këto vende të lira KEC ka shpallur konkursin për aplikim për bursa.

Përgatiti: Petrit Tahiri